

REGJISTRI I KOMPANIVE

Dogana mban regjistrin e të drejtave të pronësisë intelektuale, për të cilat është miratuar kërkesa për ndërmarrjen e veprimeve.

VEPRIMET E DOGANËS SIPAS KËRKESËS PËR VEPRIM

DOGANA

-Ka të drejtë të ndalojë mallrat të cilat dyshohen se shkelin një të drejtë të PI-së, për të cilën është paraqitur kërkesa për veprim.

-Lajmëron brenda 1 ditë pune deklaruesin e mallit;

DEKLARUESI I MALLIT




-Ka afat 10 ditë pune të pranojë apo të kundërshtojë shkatërrimin e mallit.

-Nëse deklaruesi kundërshton shprehimisht asgjësimin e mallit të sekuestruar, mbajtësi i së drejtës mund t'i drejtohet gjykatës dhe të informojë doganën brenda 10 ditëve nga data e ndalimit.

MBAJTËSI I VENDIMIT

-Njoftohet për ndalimin, në të njëjtën ditë dhe ka për obligim që ta njoftojë Doganën në afat prej 10 ditësh nëse:

-Mallrat e ndalura e shkelin apo jo të drejtën e PI-së;
-Në rastet e shkeljes, të njoftojë nëse bie dakord për shkatërrimin e mallrave.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
DOGANA E KOSOVËS

MASAT DOGANORE PËR MBROJTJEN E PRONËSISË INTELEKTUALE



PROCEDURA DOGANORE

Sektori i informimit

+383 38 500 095
0 800 500 95
SMS: 500 95

VEPRIMET DOGANORE SIPAS DETYRËS ZYRTARE (EX-OFFICIO)

DOGANA

-Ka të drejtë të ndalojë mallrat të cilat mallrat të cilat dyshohen se shkelin një të drejtë të PI-së, edhe në rastet kur nuk është paraqitur kërkesa për veprim.

-Dogana kërkon të identifikojë mbajtësin e së drejtës, nëse nuk ka mallrat lirohen;

DEKLARUESI I MALLIT



-Ka afat 10 ditë pune të pranojë apo të kundërshtojë shkatërrimin e mallit.

MBAJTËSI I VENDIMIT

- Kur identifikohet mbajtësi i së drejtës, ai mund të paraqesë Kërkesën për Veprim Doganor. Malli mbetet në mbikqyrje doganore.

SHPENZIMET

Mbajtësi i vendimit merr përsipër të gjitha shpenzimet, sidoqoftë, kjo nuk duhet ta pengojë mbajtësin e vendimit nga parashtrimi i kërkesës për kompensim nga shkelësi ose personat tjerë.



Informata të përgjithshme:

- Kategoritë e mallrave më të falsifikuara janë: veshjet, mbathjet, produktet kozmetike, farmaceutike, teknologjike, pijet alkoolike, etj.
- Ju mund të mbron pronësinë intelektuale duke paraqitur kërkesën për veprim për regjistrim pranë Doganës së Kosovës dhe të informoheni për procedura të mëtejshme.

MBROJ TË DREJTAT TUA, THUJ JO PRODUKTEVE TË FALSIFIKUARA!

Sektori i informimit

+383 38 500 095
0 800 500 95
SMS: 500 95

Dogana e Kosovës, ka përgjegjësi të veprojnë ndaj mallrave të cilat dyshohen për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale, bazuar në Ligjin Nr.06/L-015 mbi Masat Doganore për mbrojtjen e Pronësisë intelektuale.

Mallrat e falsifikuara

•Përfshirë çdo paketim, etiketë, afishe, broshurë, udhëzime për përdorim, dokument garancie ose send të ngjashëm (edhe nëse paraqitet veçmas) që janë subjekt i një akti që shkelë një markë tregtare ose një tregues gjeografik.

Mallrat pirate

•Mallrat që janë subjekt i një akti që shkelë të drejtën e autorit ose të drejtën e përafërt ose një dizajn industrial.

Mallrat e dyshuara për shkelje të një DPI

•Mallrat kur ka indikacione të arsyeshme se ato janë subjekt i një akti që shkelë një të drejtë të pronësisë intelektuale në Kosovë.

Çka përfshin pronësia intelektuale?



Si t'i mbrojmë këto të drejta përmes Doganës?

Paraqit aplikacionin për veprim doganor!



REPUBLIKA E KOSOVËS
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
DOGANA E KOSOVËS

MASAT DOGANORE PËR MBROJTJEN E PRONËSISË INTELEKTUALE



ÇFARË DUHET TË DINI?

Sektori i informimit

+383 38 500 095

0 800 500 95

SMS: 500 95

Aplikacionet e pakompletuara

Do të kërkohet nga aplikuesi që brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas pranimit të njoftimit të sigurojë informatat të cilat mungojnë.

Njoftimi lidhur me vendimin

Aprovimi/refuzimi i aplikimit bëhet brenda 30 ditëve të punës nga marrja e kërkesës.

Afati për veprim doganor

Periudha e vlefshmërisë së një kërkesë për veprim nuk duhet ta kalojë një vit, por mund të zgjatet sipas kërkesës.

Vazhdimi i afatit për veprim doganor

Kërkesa për zgjatjen e periudhës kohore gjatë së cilës Dogana e Kosovës i ndërmerr veprimet, duhet të paraqitet të paktën 30 ditë pune para skadimit të aplikimit duke përdorur formularin i cili mund të shkarkohet këtu:

<https://dogana.rks-gov.net/per-biznese/dpi/dokumentat-e-rendesishem/>

Si të plotësojmë aplikacionin?

Aplikacioni mund të shkarkohet këtu:

<https://dogana.rks-gov.net/per-biznese/dpi/dokumentat-e-rendesishem/>

Të dhënat e kërkuara:

- Emri, adresa dhe detajet e kontaktit të aplikuesit së bashku me statusin e tij;
- Të ceket e drejta e pronësisë intelektuale e cila kërkohet për tu mbrojtur;
- Dokumentet që vërtetojnë se aplikuesi ka të drejtën e paraqitjes së aplikimit;
- Të dhëna teknike specifike për mallrat origjinale, psh. shenjat si shiriti kodifikues (barkode) dhe fotografitë, sipas nevojës;
- Një përshkrim mjaft i hollësishëm i mallrave për t'ia mundësuar Doganës njohjen e mallrave;
- Emri dhe detajet e kontaktit të ekspertëve ligjor dhe teknik;
- Marrëveshjen se të dhënat e ofruara mund të përpunohen nga Dogana e Kosovës;
- Nëse ai dëshiron të kërkojë shfrytëzimin e procedurës së “dërgesës së vogël” dhe pajtohet t'i mbulojë kostot e mallrave të shkatërruara në atë procedurë.

APLIKACIONI PËR VEPRIM DOGANOR

Aplikacioni për veprim doganor

- Kërkesa që paraqitet pranë Doganës së Kosovës për të ndërmarrë veprime në lidhje me mallrat që dyshohet se shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale;

Kush mund të aplikojë?

- Bartësit e së drejtës (psh. pronarët e markave tregtare, patentave, etj);
- Organet që administrojnë të drejtat kolektive të pronësisë intelektuale,
- Grupet e prodhuesve që administrojnë treguesit gjeografik, të cilët përfaqësojnë prodhuesit e produkteve me tregues gjeografik apo emërtim të origjinës;
- Personat të autorizuar për të përdorur të drejtat e pronësisë intelektuale.

Sektori i informimit

+383 38 500 095
0 800 500 95
SMS: 500 95